

S H E N I M E T S P J E G U E S E

Sqarim:

Dhënia e shënimeve shpjeguese në këtë pjesë është e detyrueshme sipas SKK 2 i permiresuar
Plotesimi i te dhenave të kësaj pjese duhet të bëhet sipas kërkesave dhe strukturës standarde te
percaktuara ne SKK 2 te permiresuar. Rradha e dhenies se spjegimeve duhet të jetë :

- a) Informacion i përgjithsëm dhe politikat kontabël
- b) Shënimet qe shpjegojnë zërat e ndryshëm të pasqyrave financiare
- c) Shënimë të tjera shpjeguese

A I Informacion i përgjithshëm

- 1 Kuadri ligjor: Ligjit 9228 dt 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"
- 2 Kuadri kontabel i aplikuar : Stndartet Kombetare te Kontabilitetit ne Shqiperi.(SKK 2)
- 3 Baza e perqatitjes se PF : Te drejtat dhe detyrimet e konstatuara.(SSK 1)
- 4 Parimet dhe karakteristikat cilesore te perdonura per hartimin e P.F. : (SKK 1)
 - a) NJESIA EKONOMIKE RAPORTUSE ka mbajtur ne llogarite e saj aktivet,pasivet dhe transaksionet ekonomike te veta.
 - b) VIJIMESIA e veprimtarise ekonomike te njesise sone raportuse eshte e siguruar duke mos pasur ne plan ose nevoje nderprerjen e aktivitetit te saj.
 - c) KOMPENSIM midis nje aktivi dhe nje pasivi nuk ka , ndersa midis te ardhurave dhe shpenzimeve ka vetem ne rastet qe lejohen nga SKK.
 - d) KUPTUSHMERIA e Pasqyrave Financiare eshte realizuar ne masen e plete per te qene te qarta dhe te kuptushme per perdonues te jashtem qe kane njoftimi te perqjitheshme te mjaftueshme ne fushen e kontabilitetit.
 - e) MATERIALITETI eshte vleresuar nga ana jone dhe ne baze te tij Pasqyrat Financiare jane hartuar vetem per zera materiale.
 - f) BESUSHMERIA per hartimin e Pasqyrave Financiare eshte e siguruar pasi nuk ka gabime materiale duke zbatuar parimet e meposhteme :
 - Parimin e paraqitjes me besnikeri
 - Parimin e perparese se permbajtjes ekonomike mbi formen ligjore
 - Parimin e paaneshmerise pa asnjë influencim te qellimshem
 - Parimin e maturise pa optimizem te teperuar,pa nen e mbivleresim te qellimshem
 - Parimin e plotesise duke paraqitur nje pamje te vertete e te drejte te PF.
 - Parimin e qendrushmerise per te mos ndryshuar politikat e metodat kontabel
 - Parimin e krahasushmerise duke siguruar krahasimin midis dy periudhave.

A II Politikat kontabël

Per percaktimin e kostos se inventareve eshte zgjedhur metoda "Mesatare e ponderuar"
(SKK 4)

Vleresimi fillestar i nje elementi te AAM qe ploteson kriteret per njoftje si aktiv ne bilanc eshte vleresuar me kosto. (SKK 5; 11)

Per prodhimin ose krijimin e AAM kur kjo financohet nga nje hua,kostot e huamarrjes (dhe interesat) eshte metoda e kapitalizimit ne koston e aktivit per periudhen e investimit.(SKK 5)

Per vleresimi i mepaseshem i AAM eshte zgjedhur modeli i kostos duke i paraqitur ne bilanc me kosto minus amortizimin e akumuluar. (SKK 5)

Per llogaritjen e amortizimit te AAM (SKK 5) njesia jone ekonomike ka percaktuar si metode te amortizimit te ndertesave metoden lineare dhe per AAM te tjera metoden e amortizimit mbi bazen e vlefte se mbetur ndersa normat e amortizimit jane perdonur te njellojta me ato te sistemit fiskal ne fuqi dhe konkretisht :

- Per ndertesat me 5 % te vlefte se mbetur
- Kompjutera e sisteme informacioni me 25 % te vlefte se mbetur
- Te gjitha AAM te tjera me 20 % te vlefte se mbetur

Per llogaritjen e amortizimit te AAJM (SKK 5) njesia ekonomike raportuese ka percaktuar si metode te amortizimit metoden lineare me normen e amortizimit me 15 % ne vit.

SHENIMET SPJEGUESE

B Shënimet qe shpjegojnë zërat e ndryshëm të pasqyrave financiare

C Shënime të tjera shpjegeuse


Ngjarje te ndodhura pas dates se bilancit per te cilat behen rregullime apo ngjarje te ndodhura pas dates se bilancit per te cilat nuk behen rregulline nuk ka.

Gabime materiale te ndodhura ne periudhat kontabel te mepareshme te konstatuara gjate periudhes rrapiortuese dhe qe korigjim nuk ka.

Hartuesi i Pasqyrave Financiare
(ELENI SHERI)

Eleni Sheri
Sheri

Per Drejtimin e Njesise Ekonomike
(Lulzime RAMI)

Lulzime Rami


Shoqëria "R & R GROUP" SHPK

Shënime Pasqyrat Financiare për periudhën 1 Janar – 31 Dhjetor 2019

1. Kuadri Kontabël i Aplikuar

Pasqyrat financiare te periudhës 01. Janar 2019-31 Dhjetor 2019, ne përbërje të të cilave janë Bilanci, Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve, Pasqyra e Fluksit të Parasë, Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital ne datë të mësipërme janë përgatitur ne baze te kërkesave te Ligjit nr. 9228 date 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", nenet 4 deri 18 te ketij ligji dhe Standardet Kombëtare te Kontabilitetit ne vendin tone.

Bilanci ne përbërje te pasqyrave financiare tregon pozicionin financier (aktivet pasivet dhe kapitalin) te shoqërisë "R & R Group" shpk me date 31.12.2019.

Pasqyra e te Ardhurave dhe Shpenzimeve tregon perfomancën ekonomike (te ardhurat, shpenzimet dhe fitim humbjen) te Shoqërisë "R & R Group" shpk për periudhën 01.01.2019 deri 31.12.2019.

Pasqyra e fluksit monetar tregon fluksin e parave (Arkëtimet dhe pagesat ne para dhe ekivalenet e saj) te Shoqërisë "R & R GROUP" shpk per periudhën 01.01.2019-31.12.2019.

Pasqyrat e ndryshimeve ne kapital tregon ndryshimet ne kapitalin e shoqërisë "R&R GROUP" shok për periudhën 01.01.2019-31.12.2019.

I. Informacione përgjithshme

1.1 Te dhëna për Shoqërinë

Shoqëria "R & R GROUP" shpk është regjistruara me date 07.02.2008 nga QKB Tirane si shoqëri tregtare. Selia e shoqërisë është Tirane Kamez Lagjia Valias, Rruga "Skënderbeu" Ndërtese private, Zone Kadastrale Nr. 2066 Numër Pasurie 25/13

Kapitali themeltar i shoqërisë ne vlerën 113.000.000 leke zotërohet nga ortaku i vetëm Elona Rami 100%.

Objekti i veprimitarisë është Import Export, shitje me shumice dhe pakice automjetesh dhe pjesësh këmbimi te automjeteve etj. Tregti me shumice dhe pakice artikuj te ndryshëm etj.

1.2 Baza e përgatitjes

Ligji i ri për kontabilitetin promovon zbatimin ligjor te standardeve nga shoqëritë.

Shoqëria ka vene ne zbatim aplikimin e Ligjit për kontabilitetin për përgatitjen e Pasqyrave financiare për periudhën ushtrimore 01.01.2019-31.12.2019. Ato përfshijnë standardet e aprovuara nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit dhe interpretimet e standardeve te shpallura nga Ministria e Financave.

Baza e përgatitjes Pasqyrave Financiare : Te drejtat dhe detyrimet e konstatuara (SKK 1; 35). Parimet dhe karakteristikat cilësore te përdorura për hartimin e pasqyrave Financiare (SKK 1; 37-69)

a) NJESIA EKONOMIKE RAPORTUESE ka mbajtur ne llogarite e saj aktivet pasivet dhe transaksionet ekonomike te veta.

b) VIJIMESIA e veprimitarisë ekonomike te njësisë sonë raportuese është e siguruar duke mos pasur ne plan ose nevoje ndërprerjen e aktivitetit te saj.

c) KOMPESIM midis një aktivi dhe një pasivi nuk ka, ndërsa midis te ardhurave dhe shpenzimeve ka vetëm ne rastet qe lejohen nga SKK.

- d) KUPTUSHMERIA e Pasqyrave Financiare është realizuar ne masen e plote për te qene te qarta dhe te kuptueshme për përdorues te jashtem qe kane njojuri te mjaftueshme ne fushen e kontabilitetit.
- e) Materialiteti është vlerësuar nga ana jone dhe ne baze tete tij. Pasqyrat Financiare jane hartuar vetëm per zerat material.
- f) Besueshmëria për hartimin e pasqyrave Financiare është e siguruar pasi nuk ka gabime materiale duke zbatuar parimet e mëposhtme:
 - Parimin e paraqitjes me besnikëri
 - Parimin e perparese se përbajtjes ekonomike mbi formën ligjore
 - Parimin e paanshmërisë pa asnjë influencim te qëllimshëm
 - Parimin e maturisë pa optimizëm te tepruar e pa nen vlerësim e mbivlerësim te qëllimshëm.
 - Parimin e plotësisë duke paraqitur një pamje te vërtete e te drejte PF
 - Parimin e qendrushmerise per te mos ndryshuar politikat e metodat kontabël
 - Parimin e krahasushmerise duke siguruar krahasimin midis dy periudhave.

Rregullat e Vlerësimit dhe Paraqitjes se Llogarive Vjetore ne Shqipëri janë përfshire ne shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare të vittit 2019

II. Politikat kryesore kontabile.

Një përbledhje e pjesës me te madhe te politikave kontabël te aplikuara ne Pasqyrat financiare janë si me poshtë:

2.1 Mjetet Monetare

Për Mjetet monetare ne arke dhe ne banke është aplikuar politika kontabël e vlerësimit "Vlera e drejte", sipas paragrafit nr. 22 te SKK-se nr. 3. Mjetet monetare ne monedha te huaja janë vlerësuar ne monedhën baze me kursin e Bankës se Shqipërisë qe daton 31.12.2019.

2.2. Aktivet e tjera financiare afatshkurtra.

Për Aktivet e Tjera financiare Afatshkurtra te paraqitura ne daten e mbylljes se bilancit 31.12.2019 është aplikuar politika kontabël e vlerësimit "Kosto historike minus zhvlerësimin e mundshëm", sipas paragrafit nr.26,27 te SKK-se nr.3. Për vitin aktual vlerësimi i tyre është bere me vlerën nominale ne krijim te tyre.

2.3. Inventari

Për Inventarin e paraqitur ne datën e mbylljes se bilancit 31.12.2019 eshte aplikuar politika kontabël e vlerësimit "Kosto historike",sipas paragrafit nr. 14, 15 te SKK-se nr. 4.

Kostoja është llogaritur duke përdorur Metoden e mesatares se ponderuar.

2.4. Huat dhe parapagimet.

Për Huat dhe parapagimet te paraqitura ne datën e mbylljes se bilancit 31.12.2019 është aplikuar politika kontabël e vlerësimit "Kosto e amortizuar" sipas paragrafit nr. 32,33 amortizuar", sipas paragrafit nr. 32,33 te SKK-se nr.3. Vlera nominale e huamarrjeve afatshkurtera eshte amortizuar me këstet e likuidimet ne periudhe.

2.5. Kapitali

Vlera e kapitaleve dhe perberesve te tij është vlerësuar me vleren e tyre historike kontabël. Ndryshimet ne grupin kapitale kane ardhur jo si rezultat i ndonjë SKK-je.

2.6. Te Ardhurat dhe Shpenzimet.

Vlerësimi i te Ardhurave dhe shpenzimeve është bere mbi bazen e parimit te konstatimit te drejtave dhe detyrimeve ne momentin e ndodhjes.

Vlerësimi i tyre është bere sipas përcaktimeve ne paragrafët 35-37 te SKK-se nr.1 dhe te SKK-se nr.8.

Te ardhurat dhe shpenzimet klasifikohen sipas natyrës dhe sipas funksioneve.

Te ardhurat përfshijnë te ardhurat nga shitjet neto dhe te ardhurat nga

shërbimet e realizuara nga aktivitetet kryesore te shoqërisë, duke mos përfshire tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH).

Pjesa me e madhe te shitjeve te shoqërisë gjenerohen nga shitja e mallrave. Shpenzimet përfshijnë shpenzimet për materialet e konsumuara, si dhe nga shpenzimet e tjera rrjedhëse me vlerën ne momentin e ndodhjes(parimi i konstatimit te drejtave e detyrimeve)

2.7 Monedha funksionale dhe monedha e paraqitjes

Zërat e përfshire ne pasqyrat financiare vlerësohen duke përdorur monedhën e mjedisit ekonomik kryesor ne te cilin operon njësia (monedha funksionale). Pasqyrat financiare paraqiten ne leke (All), e cila është monedha funksionale dhe monedha e paraqitjes

III. Informacion – Shtese për zërat Materiale

3. Mjetet Monetare

Mjetet monetare jane paraqitur ne bilanc sipas gjendjeve te llogarive bankare ne datën e fundit 31.12.2019 e cila është e njëjtë me ekstraktet e fundit te bankave për këtë periudhe si dhe me gjendjen e arkës se Shoqërisë ne fund te muajit Dhjetor 2019. Gjendjet sipas bankave dhe arkës paraqitet:

Gjendja e “Mjetet Monetare” me date 31 Dhjetor 2019 paraqitet;

Credins ne euro(72.82)	9.057.26
Credins ne usd (67.97)	7.970.35
ProCredit Banke ne leke	0.00
ProCredit Banke ne euro(42.05)	5.210.84
Amerikan bank of investiment ne usd(-77.18)	-8.321.55
SHUMA BANKA	13.917.00
Arka	18.828.00
TOTALI	32.745.

4. Aktivet financiare afatshkurtra

Gjendja e “Aktiveve te tjera Financiare Afatshkurtra” me date 31 Dhjetor 2019 paraqitet për shumën 487.334.075 leke e cila përfaqëson:

-Klientë te faturuar e te pa arkëtuar ne 31.12.2019 ne shumën 318.478.018 leke.

-Te drejta e detyrime te tjera ne shumën 168.856.058 leke nga te cilat tatim fitimi i mbi paguar 425.848 leke dhe detyrime te tjera 68.284.977 leke te pa shlyera deri me 31.12.2019.

5. Inventarët

Gjendja e “Inventarëve” me date 31.12.2019 paraqitet ne shumën 32.011.079 leke sipas inventarit bashkëngjitur Pasqyrave Financiare

6. Aktivet afatgjata materiale

Gjendja e Aktiveve afatgjata materiale me date 31.12.2019 paraqitet:

NR	EMERTIMI	NJESI	SASI SAS	VLERE FILLEST	AMORT AKUMU	AMORT VJETOR	SHITJE SHITJE	VL E MBETUR
1	Furgon Benz	Cope	1	600,000	462,129	-		137,871
2	Ford tourneo	Cope	1	525,618	-	-		525,618
	SHUMA MjeteTransporti			1,125,618	462,129	-		663,489
3	Pirunngrites	Cope	1	125,000	71,666	-		53,334
4	Shtylle	Cope	1	14,000	8,146	-		5,854
5	PaisjeSistemRujtje	Cope	1	134,750	65,758	-		68,992
6	MjetPirun	Cope	1	93,900	33,804	-		60,096
7	Sistemkamera+alarmi	Cope	1	199,465	58,510	-		140,955
	SHUMA MakineriPaisje			567,115	237,884	-		329,231
8	Raftemetalike	Cope	2	20,052	9,785	-		10,267
9	Raftemetalike	Cope	1	30,835	14,665	-		16,170
10	Kondicionere	Cope	4	128,000	50,176	-		77,824
11	Televizor	Cope	1	83,325	16,665	-		66,660
	SHUMA Pajisjezyre			262,212	91,291	-		170,921
12	Kompjuter	Cope	2	39,998	33,850	-		6,148
13	Kompjuter	Cope	1	25,667	16,170	-		9,497
14	Kompjuter	Cope	1	27,500	-	-		27,500
	ShumalInformatike			93,165	50,020	-		43,145
	SHUMA			2,048,110	841,324	-	-	1,206,786

7. Detyrimet Afatshkurtra

- Te pagueshme ndaj furnitorëve 311.843.168 leke
- Te pagueshme ndaj punonjësve 2.413.436 leke
- Detyrime Sig. Shoq e TAP 56.232 leke
- Tatim ne burim 6.000 leke
- Detyrim për tvsh 2.000.769 leke
- Detyrim ndaj Inst te Kredise 18.961.338 leke

SHUMA 335.281.043

Detyrimet ndaj furnitorëve perfaqesojne faturat e materialeve te blera dhe te pa likuiduara deri ne datën 31.12.2019.

Detyrimet ndaj punonjësve perfaqesojnë pagat e pa likuiduara deri me 31.12.2019.

Detyrimet ndaj Sigurimeve shoqërore Tap Tvsh e tatim ne burim perfaqesojne detyrimet e muajit dhjetor 2019 te cilat paguhen ne Janar 2020.

Detyrime ndaj Institucioneve te kredisë paraqet detyrim për overdraft.

7.1 Detyrimet afatgjata

Detyrimet afatgjata ne Shumën **57.003.386 leke** perfaqesojne Kredine bankare te marre ne banke per nevoje te aktivitetit.

8. Kapitali

Gjendja e grupit te Kapitaleve me date 31.12.2019 paraqitet:	
Kapitali	31 Dhjetor 2019
Kapitali ortakërisë	113.000.000 leke
Rezerva Ligjore	1.448.936 leke
Rezerva te tjera	5.213.138 leke
Fitime te pashpërndara	7.728.637 leke
Fitimi/Humbja e vtitit finanziar	909.546 leke
Totali	128.300.257 leke

Kapitali ka ndryshime ne rritje nga fitimi i vtitit 2019 ne vlerën 909.546 leke

9. Fitim/Humbja e vtitit Financiar

Fitim/Humbja e Vtitit Financiar 2019 është rezultante e Te Ardhurave ushtrimore dhe shpenzimeve ushtrimore. Ne pasqyrën e mëposhtme do te paraqitet formula e Fitim/Humbjes te Vtitit Financiar 2019

10. Te Ardhurat

Për periudhën kontabël qe mbyllt 01 Janar 2019 – 31 Dhjetor 2019 shoqëria ka realizuar te ardhura te cilat rrjedhin nga shitja e mallrave dhe shërbimeve te kryera.

Te ardhurat e ushtrimit ne vlerën 218.150.711 leke kane ardhur :

1. Nga shitja e mallrave ne vlerën 218.150.711 leke.

11. Shpenzime për Blerje Mallrash

Shpenzimet për materialet e konsumuara përfshijnë shpenzimet per blerjen e mallrave gjate vtitit 2019 duke shtuar inventarin ne fillim te vtitit dhe duke zbritur inventarin ne fund te vtitit si me poshtë:

Blerje mallra materiale gjithsej	205.999.706 leke
+Gjendje e inventarit ne fillim	30.159.314 leke
-Gjendje e inventarit ne fund	32.011.079 leke
Te tjera shpenzime	625.363 leke
Materiale te konsumuara	204.773.302 leke

12. Shpenzimet e Personelit

Ne shpenzimet për personelin, janë përfshire shpenzimet per paga dhe sigurime shoqërore e shëndetësore vetëm pjesa qe paguan punedhenesi.

Paga punonjësish	2.488.548 leke
Sigurime shoqërore e shëndetësore	313.796 leke
Shuma	2.802.344 leke

13. Shpenzimet e amortizimit.

Shpenzimet për amortizimin janë zero leke

14. Shpenzime te tjera te shfrytëzimit.

Ne shpenzimet e tjera te shfrytëzimit ne shume 4.216.912 leke jane perfshire shërbimet e kryera nga te tretet si me poshtë:

Shpenzime qeraje	480.000 leke
Mirëmbajtje riparime	6.417 leke
Siguracione	85.277 leke
Te tjera	507.434 leke
Personel jashtë ndërmarrjes	159.304 leke
Shpenzime postare e telefonit	55.000 leke
Shpenzime transporti	117.776 leke
Gjoba dhe dëmshpërblime	2.805.704 leke
Shuma	4.216.912 leke

15. Shpenzimet Financiare ne vlerën 4.938.208 leke perfaqesojne shpenzime për interesat bankare i 2.818.803 leke dhe komisionet bankare 2.119.405 leke për kreditë bankare te marra per nevojat e aktivitetit.

16. Fitimi

Te Ardhurat	218.150.711 leke
Shpenzimet	216.585.533 leke
Fitimi ushtrimit	1.565.178 leke
Shpenzime te pa zbritshme	2.805.704 leke
Fitimi fiskal	4.370.882 leke
Tatimi i fitimit	665.632 leke

17. Ngjarje pas datës bilancit kontabël

Ngjarje te tjera mbas datës se bilancit, te cilat mund te kishin ndikim ne rezultatin financiar te shoqërisë për periudhën Janar – Dhjetor 2019, nuk ka.

Hartues i Pasqyrave Financiare

Eleni SHERI

Administratori

Lulzime RAMI

